



Në bazë të nenit 103 të Ligjit mbi arsim të lartë të RMV-së („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 82/18), Statutit të Universitetit të Tetovës, Rregullores për kriteret dhe kushtet e regjistrimit në studimet e ciklit të parë dhe Rregullores për sistemin e kredive dhe transferimit në njësitë akademike, Vendimit nga mbledhja e Këshillit të Rektoratit nr. 02-1089/1 më 03.07.2025 dhe Konkursit për regjistrim të studentëve në vitin akademik 2025/26, Universiteti i Tetovës shpall:

## N J O F T I M

**për transferimin dhe regjistrimin e studentëve në fakultetet dhe njësitë akademike të Universitetit të Tetovës në semestrin dimëror 2025/26**

### I. Transferimi do të realizohet në programet studimore aktive:

1	Fakulteti Ekonomik	8	Fakulteti i Kulturës Fizike
2	Fakulteti Juridik	9	Fakulteti i Shkencave të Zbatuara
3	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	10	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit
4	Fakulteti i Shkencave Mjekësore	11	Fakulteti i Administrimit të Biznesit - Kumanovë
5	Fakulteti Filologjik	12	Fakulteti Pedagogjik
6	Fakulteti Filozofik	13	Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë
7	Fakulteti i Arteve		

### II. Kushtet e transferimit brenda Universitetit të Tetovës:

#### A. Transferimi brenda UT- së:

1. Të drejtë transferimi brenda njërive akademike dhe programeve studimore të UT-së kanë të gjithë studentët e UT-së, sipas kushteve dhe kriterëve aktuale të caktuara me Rregulloren për studime;
  - 1.1 Të drejtë transferimi në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në programin: Mjekësi e përgjithshme, Mjekësi dentare dhe Farmaci kanë të gjithë kandidatët/studentët të cilët vijnë nga programi i biologjisë, që e kanë kaluar me sukses lëndën e Kimisë dhe Biologjisë.
2. Transferimi i studimeve realizohet vetëm në programet studimore aktive, gjegjësisht semestrin aktiv në të cilin është duke u realizuar programi studimor;
3. Pas realizimit të transferimit të ECTS kredive, studenti gjatë regjistrimit në programin e transferuar, është i obliguar t'i çregjistrojë studimet nga programi i cili transferohet, varësisht natyrës së programit studimor dhe mënyrës së studimeve (të rregullta);
4. Të drejtë transferimi brenda njërive akademike të UT-së, kanë studentët dhe kandidatët të cilët kanë përfunduar së paku një semestër;
5. Transferimi i ECTS kredive mund të bëhet edhe në drejtimet brenda programit të njëjtë studimor dhe në mes planprogrameve të studimeve të ndryshme brenda të të njëjtit program studimor. Diferencat dhe ngjashmëritë e lëndëve i përcakton Koordinatori për ECTS i fakultetit dhe Komisioni për transfer dhe regjistrim;
7. Komisioni për transfer dhe regjistrim, përcakton nëse natyra e programit studimor prej ku transferohet kandidati është e përshtatshme për programin përkatës;
8. Transferim të kredive mund të realizojnë edhe studentët të cilët i kanë përfunduar studimet, në përputhje me Rregulloren për transferim të kredive.

#### B. Kandidatë/Studentë nga universitetet tjera:

1. Të drejtë transferimi nga institucionet tjera të arsimit sipëror nga RMV dhe jashtë, në njësitë akademike të UT-së, kanë të gjithë kandidatët që kanë regjistruar dhe të përfunduar (dëgjuar) së paku një semestër nga universiteti prej ku vjen kandidati, ndërsa detyrimet tjera i kryejnë varësisht statusit të transferimit;
  - 1.1. Në programet studimore Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi Dentare dhe Farmaci kanë të drejtë të aplikojnë vetëm kandidatët të cilët vijnë nga programet e njëjta studimore.
2. Gjatë aplikimit, detyrimisht kandidati duhet të paraqes dëshmi për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë, respektivisht fakultetit apo programit nga i cili transferohet ose dokumente shtesë varësisht kërkesës së Komisionit për transfer dhe regjistrim (syllabuset, etj);
3. Dëshmi për nostrifikimin e shkollimit të mesëm dhe Vendim për ekuivalentimin e notave nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RMV-së (për shtetasit e huaj ose shkollim të mesëm jashtë vendit me sistem të ndryshëm të vlerësimit);

4. Studenti mund të transferohet në fakultetin dhe programin e njëjtë studimor ose në drejtime të ngjashme me fakultetet dhe programet studimore të UT-së. Ngjashmërinë e programeve studimore e përcakton Komisioni i fakultetit për transfer dhe regjistrim;

5. Komisioni i fakultetit për transfer dhe regjistrim, përcakton nëse natyra e programit studimor prej ku transferohet kandidati është e përshtatshme për programin përkatës.

C. Kandidatët që transferohen, regjistrohen me koфинancim në studime, respektivisht sipas tarifave aktuale të studimit për programet studimore në vitin akademik 2025/26.

D. Në programet studimore, për të cilat në Konkursin për transfer dhe regjistrim janë përcaktuar provime pranuese (kontroll i talentit), kandidatët që aplikojnë për transferim të kredive, janë të obliguar t'i nënshtrihen provimit pranues në lëndë përkatëse.

E. Në rast se numri i kandidatëve është më i lartë se sa ka vende të lira në programin studimor, atëherë përparësi kanë kandidatët të cilët kanë arritur notë më të lartë mesatare. Komisioni mund të vendos edhe kritere plotësuese për selektim.

**H. Regjistrimi i lëndëve jo të transferuara bëhet në kontinuitet sipas realizimit të programit aktiv studimor dhe bëhet në bazë të parakushteve për dëgjim. Përgjatë një semestri lejohet regjistrimi i lëndëve deri 35 ECTS. Statusi i semestrit përcaktohet varësisht njohjes së kredive, ndërsa studenti i regjistron lëndët jo të transferuara me radhë sipas vendimit të transferit.**

### III. Afatet e paraqitjes për transferimin dhe regjistrim në semestrin dimëror 2025/26:

<b>REALIZIMI I KONKURSIT PËR TRANSFER DHE REGJISTRIM TË STUDENTËVE – 2025/26</b>	
Paraqitja e kandidatëve (aplikimi në administratën e fakultetit)	<b>25.08 -12.09. 2025</b>
Sjellja e vendimeve preliminiare për pranim të kandidatëve (Kandidati vendimin preliminar e pranon në e-mail, me të cilin ka aplikuar)	<b>17.09.2025</b>
Provimi pranues (për programet e caktuara studimore)	<b>13.09.2025</b>
Sjellje e vendimeve përfundimtare	<b>48 orë pas pranimit të versionit preliminar</b>
Regjistrimi i kandidatëve të transferuar*	<b>22.09 - 26.09.2025</b>

**\* KANDIDATËT TË CILËT NUK DO TA BËJNË REGJISTRIMIN E SEMESTRIT NË KOHËN E CAKTUAR, DO TA HUMBIN TË DREJTËN PËR TRANSFERIM TË ECTS KREDIVE**

\* Kandidati i cili e regjistron semestrin dhe lëndët, statusi i transferimit konsiderohet përfundimtar dhe nuk mund të korrigohet.

### IV. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kandidatët e plotësojnë formularin online në ueb faqen: [apply.unite.edu.mk](http://apply.unite.edu.mk). Pas aplikimit në sistemin elektronik, kandidatët duhet që dokumentet t'i dorëzojnë në administratë brenda afatit të caktuar:

A. Pas aplikimit on-line, në emailin e tyre kandidatët pranojnë konfirmim dhe link për aktivizimin e profilit të aplikuesit, prej ku i përcjellin të gjitha fazat e shqyrtimit të dokumenteve, rezultateve dhe regjistrimit;

2. Gjatë plotësimit të formularit, kandidatët dokumentet duhet t'i bashkangjesin (attach) të skenuara ose si fotografi (skenimi ose fotografitë duhet të jenë të lexueshme dhe ta përfshijnë dokumentin e plotë me të gjitha të dhënat në të dy anët e fletës);

- **Certifikata origjinale e notave dhe Indeksi** nga universiteti amë (nëse ka dhënë provime dhe universiteti lëshon indeks);

- **Dëftesat origjinale** nga shkollimi i mesëm (ose të verifikuara në noter) dhe **diplomën e shkollës** së mesme të kryer;

- **Certifikatë nga libri amzë i lindjes** dhe **Certifikatë për shtetësi**;

- Kandidatët me shkollim të mesëm jashtë RMV-së dhe certifikatë të notave të lëshuar nga universitetet jashtë RMV-së, duhet të realizojnë nostrifikim të shkollës së mesme dhe ekuivalentim të certifikatës së notave për njohje të pjesshme të shkollimit në Ministrinë e arsimit dhe shkencës së RMV-së.

- Kandidatët që transferohen nga jashtë Universitetit të Tetovës, duhet të dorëzojnë dëshmi për akreditimin e programit studimor;

- **Vërtetim për pagesën:**

a) **1050 denarë** në xhirollogarinë e Universitetit në emër të taksave administrative;

b) **600 denarëve** për provim pranues (Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi Dentare dhe Farmaci, Artet, Kulturë Fizike dhe Shëndetësi, Arkitekturë, Edukim Parashkollor dhe Mësim Klasor).

Kandidatët të cilët janë të pranuar (pas shpalljes/dhënies së vendimit përfundimtar), në afatin e caktuar duhet të realizojnë regjistrimin e studimeve, në të kundërtën vendimi i transferimit do të shpallet i pavlefshëm.

## V. Regjistrimi pas përfundimit të procedurës për transferim:

1. Kandidatët të cilët pajtohen me vendimin e transferit, duhet brenda afatit ta bëjnë regjistrimin e semestrit përmes profilit elektronik të aplikimit të cilin e kanë pranuar në emailin prej ku kanë aplikuar
  - a. Fillimisht bëhet regjistrimi online dhe më pas dokumentet më poshtë i dorëzojnë në administratë.
  - b. Pas fazës së regjistrimit, studentit i krijohet email zyrtar me të cilin e aktivizojnë profilin e studentit dhe i regjistrojnë lëndët jo të transferuara. Niveli i semestrit përcaktohet në sistem pas hapjes së profilit elektronik të studentit.
2. Aktvendim ose dëshmi për çregjistrimin e studimeve nga fakulteti i cili transferohet (varësisht mënyrës së studimeve);
3. Tri fotografi (*dy fotografi 6x9 cm dhe një fotografi 4x5 cm*);
4. Vërtetim për pagesën e mjeteve:
  - **100 denarë** në xhirollogarinë 240190104749495 (banka e pranuesit: Uni Banka AD Skopje): në emër të Parlamentit Studentor në Universitetin e Tetovës (SHPSUSHT);
  - **1200 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit në emër të dhënies së Index-it;
  - **750 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit;
  - **6000 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit në emër të shpenzimeve për realizimin e transferimit;
  - **Pagesën për semestër.**

**Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhirollogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:**

**Pagesa prej Maqedonisë së Veriut online: <https://epay.unite.edu.mk/> ose**

- Pagesat mund të bëhen edhe përmes aplikacioneve elektronike bankare me formular **PP50** ose me fletëpagesë në bankë/postë;
- Fletëpagesa qoftë përmes aplikacionit ose fletëpagesës në bankë, duhet të figurojë në **emër të studentit**;
  - ❖ në emri i marrësit (**назив на примачот**) - Universiteti i Tetovës,
  - ❖ në „banka e marrësit” (**банка на примач**) - Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
  - ❖ në „llogaria” (**сметка**) – **10000000063095**,
  - ❖ në „shuma” (**износ**) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhen,
  - ❖ në „llogaria e shfrytëzuesit buxhetor - subjekti shfrytëzues” (**сметка на буџетски корисник – единка корисник**) – **1600160054 788 10**;
  - ❖ në „shifra dhe programi i të hyrave” (**приходна шифра и програма**) – **723019 43**, ndërsa në „mënyra” (начин) – **2**;
  - ❖ në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (**цел на дознака**) – qëllimi i pagesës (aplikim, semestri, indeks, provim pranues).
  - ❖ Në rast se pagesat përmes aplikacioneve bankare i kryen person tjetër për studentin e caktuar, në këtë rubrikë (**цел на дознака**) - qëllimi i pagesës), e shënon edhe emrin e studentit për të cilin e kryen pagesën (shembull: aplikim Emri dhe Mbiemri)

**Pagesa prej jashtë shtetit: <https://epay.unite.edu.mk/>  
NATIONAL BANK OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA  
NAME: UNIVERZITET VO TETOVO  
IBAN: MK07 1007 0100 0066 227  
SWIFT BIC: NBRM MK 2X**

<http://www.unite.edu.mk> , Tetovë, Korrik, 2025